



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E PUNËVE TË  
JASHTME**

**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministrisë së Punëve të Jashtme*, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Pleurat Isufi (udhëheqës i ekipit), si dhe Fjolla Bakalli-Sadiku dhe Albana Kadriu-Zogjani (anëtare të ekipit) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Qeverisja e mirë.....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	28
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	30

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i Kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç shumës së shpenzuar për mallra dhe shërbime prej 343,527€, për të cilën nuk janë bërë barazimet e fundvitit me regjistrin kontabël.

#### Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të përmendim faktin se MPJ në fund të vitit 2018 nuk kishte regjistruar në regjistra 99,413€ pasuri të blera gjatë vitit me vlerë nën 1,000€, si dhe pasurinë e paprekshme (softuer) në vlerë 128,532€ e pranuar si donacion në vitin 2013. Gjithashtu, ekziston edhe një mospërputhje e gjendjes së avanceve të pa arsyetuara në vlerën prej 36,430€ të prezantuara në PFV dhe gjendjes kontabël në SIMFK.

Më gjerësisht, shih kapitullin 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund ti gjenden në Shtojcën II.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i Kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin e Bazës për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion të Kualifikuar

Në fund të vitit 2018 MPJ kishte një bilanc të shpenzimeve të pambyllura në Misionet Diplomatie Konsullore (MDK) në vlerë 343,527€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime. Sipas evidencave të ministrisë, bilanci i këtyre shpenzimeve për vitet paraprake ishte 200,058€, ndërsa për vitin aktual kjo shumë është rritur edhe për 143,469€. Megjithatë, kjo shumë mund të jetë edhe më e lartë duke marrë parasysh thyerjet midis hyrjeve dhe daljeve të paregjistruara në MDK ku përfshihen shpenzime të paregjistruara, të hyra dhe rimbursimet e paregjistruara, diferenca për shkak të kurseve të këmbimit, gabime në regjistrime etj.

Arsye për këtë është se shumat prej 200,058€ janë grumbulluar për vite me radhë, dhe në mungesë të dokumentacionit, MPJ nuk ka arritur t'i sqaroj këto shuma të shpenzuara nga Misionet Diplomatike Konsullore (MDK) që operojnë jashtë vendit. Pra, shkak është mungesa e raportimit dhe dëshmimeve për arsyetimin e shpenzimeve. Për të njëjtat arsye, kjo shumë në fund të vitit 2018 ishte rritur edhe për 143,469€.

Ky problem është raportuar edhe gjatë viteve të mëparshme, por MPJ nuk ka arritur që ta zgjidhë dhe t'i vendos nën kontroll shpenzimet dhe raportimet me kohë të MDK-ve. Pas pranimit të draftraportit të auditimit, Ministria kishte marrë masa të menjëhershme dhe deri para finalizimit të këtij raporti ka arritur t'i arsyetoj me dëshmi dhe ti mbyll shpenzimet e ambasadave në vlerë prej 185,642€.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Theksimi i çështjes**

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet në vijim:

- MPJ nuk i kishte regjistruar në regjistra të pasurisë 99,413€ pasuri nën 1,000€ të blera gjatë vitit, dhe pasurinë e paprekshme (softuer) në vlerë 128,532€, e cila është pranuar si donacion në vitin 2013. Rrjedhimisht vlera e pasurive, e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar; dhe
- Vlera e avanceve të pa arsyetuara, e shpalosur në PFV ishte më e vogël se ajo në shënimet e SIMFK-së. Në PFV janë prezantuar 193,868€, ndërsa sipas shënimeve të SIMFK-së, vlera e avanceve të hapura ishte 230,298€. Nga kjo, shuma e paguar me kredit kartela e pa arsyetuar është 67,959€, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me avance për ambasadat, dhe avance për udhëtime zyrtare. Lidhur me avancet, më gjerësisht, shih kapitullin 3.3 të këtij raporti.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për zbatimin e kontroleve të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Punëve të Jashtme është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme.



---

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MPJ kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMPPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV-të, përveç çështjeve që janë potencuar tek opinionin dhe theksimi i çështjes, ne kemi vërejtur se nuk janë dhënë detaje dhe komente për shënimet e pasqyrave, siç kërkohet me dispozitat e Rregullës 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ, me rastin e dërgimit të PFV-ve në Thesar-MF, nuk mund të konsiderohet plotësisht e saktë dhe e plotë.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

**Rekomandimi C1** Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet adekuate për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paregjistruara që po përsëriten vit pas viti. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë që e gjithë pasuria e blerë të regjistrohet në regjistra, dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta në lidhje me pasuritë. Veç kësaj, Ministri duhet të sigurojë që për të gjitha shënimet e prezantuara në PFV, do të bëhen shpjegime sqaruese, në mënyrë që ato të jenë të jenë të kuptueshme për shfrytëzuesit e tyre. Avancet e pa arsyetuara duhet të prezantohen me vlera të sakta dhe të jepen shpjegimet e nevojshme për to.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtjeshëm për të parandaluar parregullsitë në shpenzime. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë, menaxhimi i shpenzimeve në MDK, realizimi i buxhetit dhe prokurimi. Menaxhimi i pasurisë po ashtu ka nevojë të përmirësohet. Kontrollet në mbledhjen e të hyrave në përgjithësi janë të përshtatshme por ende ka vonesa të theksuara në regjistrim të cilat duhet të evitohen.

Edhe më tutje çështja më sfiduese mbetet trajtimi dhe identifikimi i shpenzimeve të pambyllura nga vitet paraprake. Këtë vit ishin mbyllur një shumë e vogël e shpenzimeve që i përkasin periudhave të kaluara.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>30,201,939</b>	<b>26,113,776</b>	<b>24,604,204</b>	<b>20,430,293</b>	<b>19,213,681</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	30,201,939	25,911,457	24,592,479	20,410,343	19,183,401
Donacionet e brendshme	0	13,225	11,725	0	0
Donacionet e jashtme	0	189,094	0	19,950	30,280

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,088,163€ apo 15.6%. Zvogëlimi i buxhetit në këtë përqindje ishte pasojë e planifikimit të dobët të buxhetit fillestar, me vendime të Qeverisë të cilat kishin për qëllim rialokimin e buxhetit të pashpenzuar.

Në vitin 2018, MPJ kishte shpenzuar 94% të buxhetit final ose 24,604,204€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2017.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>30,201,939</b>	<b>26,113,776</b>	<b>24,604,204</b>	<b>20,430,293</b>	<b>19,213,681</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,755,341	7,044,411	7,044,411	6,432,342	5,759,871
Mallrat dhe Shërbimet	16,203,547	17,673,107	16,560,738	13,268,981	12,088,464
Shërbimet komunale	588,051	572,408	459,380	521,719	380,578
Subvencionet dhe Transferet	100,000	12,877	12,877	33,450	364,470
Investimet Kapitale	6,555,000	810,973	526,798	173,801	620,298

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga, ishte rritur për 289,070€ krahasuar më atë fillestar. Kjo rritje është bërë me vendim të Qeverisë. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,457,575€ me vendim të Qeverisë si dhe 13,225€ nga donacionet e brendshme.
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 5,744,027€. Ky zvogëlim ishte bërë më vendime të Qeverisë, në emër të reduktimeve pasi që të njëjtat nuk kanë mundur të shpenzohen nga MPJ.

## Rekomandimi

### Çështja B1<sup>2</sup> - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për investime kapitale

#### Gjetja

Sipas Ligjit të Buxhetit, për secilin nga projektet kapitale ndahet buxheti i veçantë dhe si i tillë ky buxhet do të duhej edhe të shpenzohet. MPJ për vitin 2018 kishte planifikuar 11 projekte kapitale në vlerë 6,555,000€, ndërsa kishte shpenzuar 526,798€ apo 8%. Vetëm 4 nga 11 projektet e planifikuara, ishin realizuar. Si rezultat i kësaj, në fund të vitit MPJ këto mjete është detyruar t'i deklarojë si fonde të pa shpenzuara dhe të njëjtat janë marrë me vendim të Qeverisë.

Realizimi i ulët i buxhetit të investimeve kapitale ishte kryesisht si rezultat i planifikimit jo real të buxhetit në këtë kategori, dhe kjo po e përcjell MPJ-në për vite me radhë.

<sup>2</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
 Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
 Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

**Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit për investimet kapitale rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, dhe redukton numrin e projekteve të realizuara.

**Rekomandimi B1** Ministri duhet të ndërmarr një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ulët të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Planifikimi i buxhetit duhet të harmonizohet me projektet e gatshme për realizim, dhe procedurat e prokurimit të inicohen me kohë dhe në pajtim me alokimet buxhetore.

### 3.1.1 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPJ në 2018 ishin 4,498,318€. Ato kanë të bëjnë me: taksa për dokumente të udhëtimit, taksë për verifikim të dokumenteve, taksë për letërnjoftim, taksë për shtetësi, taksë për vulë apostile etj

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,464,270	1,464,270	4,498,318	3,153,732	2,546,086

Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një trend në rritje krahasuar me vitet paraprake. Krahasuar me vitin 2017 kishte rritje në inkasimin e të hyrave për 1,344,586€, apo shprehur në përqindje 42.6%. Kjo rritje vjen kryesisht nga taksa në dokumente të udhëtimit ku rritja e inkasimit krahasuar me vitin paraprak ishte për 1,047,837€, nga taksa në letërnjoftim 138,781€ dhe të hyrat tjera ku trendi i rritjes ishte më i ulët.

### Rekomandimi

#### Çështja B2 - Vonesa në regjistrimin e të hyrave

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat vetjake, regjistrimi i të hyrave në SIMFK duhet të bëhet në baza ditore, derisa barazimet me Thesarin në baza mujore.

Ne kemi vërejtur se edhe këtë vit kishte vonesa në regjistrimin e të hyrave në SIMFK. Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në raportimin e të hyrave nga ana e MDK-ve.

**Rreziku** Vonesat në regjistrimin e të hyrave, ndikojnë në cilësinë e raportimit dhe pamundësojnë kryerjen e barazimeve mujore me Thesarin. Kjo rrit rrezikun e mos përfshirjes së një pjesë të të hyrave në PFV në fund të vitit.

**Rekomandimi B2** Ministri duhet të rris nivelin e përgjegjësisë tek shefat e MDK-ve dhe stafi tjetër përgjegjës, për të siguruar raportime të rregullta dhe me kohë, në lidhje me të hyrat e realizuara, në mënyrë që ato të regjistrohen me kohë në SIMFK si dhe të raportohen saktë në raportet periodike dhe në PFV.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2018 ishte 7,044,411€, dhe i njëjti ishte shpenzuar në tërësi. Pagat dhe shtesat paguhen përmes sistemit të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Financave. Megjithatë, ekzistojnë një sërë kontrollesh në kuadër të MPJ e që lidhen me ndryshimet e listave të pagave, kalkulimin dhe aprovimin e shtesave, etj. Ne kemi përzgjedhur 100 mostra për testim substancial dhe tetë (8) mostra për testim të pajtueshmërisë. Testimet audituese nuk kanë vënë në pah ndonjë parregullësi në lidhje me pagat dhe mëditjet.

Ndërsa në lidhje me menaxhimin e personelit kemi evidentuar çështjen e mëposhtme:

#### Çështja C2 - Mbajtja e pozitës së Ambasadorit pas mandatit katër vjeçar, pa vendim për zgjatjen e mandatit

**E gjetura** Bazuar në Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 22, përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër vjeçare, ose siç kërkohet ndryshe për të përmbushur nevojat e Ministrisë. Sipas të njëjtit ligj, zgjatja e mundshme e mandatit është në diskrecion të Ministrisë. Kësi raste kishte edhe në vitin e kaluar, me ç'rast kishim rekomanduar që diskrecioni i ministrit të formalizohet me një akt, vendim apo shkresë që do të autorizonte vazhdimin e mëtejshëm të mandatit.

Ne kemi vërejtur se një Ambasador i cili ishte emëruar me datën 28.06.2013 përmes Dekretit të Presidentit, vazhdon të ushtroj detyrën e Ambasadorit dhe të marrë pagë në të njëjtin mision, edhe pse nuk ka një akt më të cilin do të vazhdohej kohëzgjatja e qëndrimit në atë mision. Paga e marrë nga Ambasadori në vitin 2018 është 53,021€.

Nga zyrtarët e ministrisë nuk na është dhënë ndonjë arsyetim i vlefshëm se pse ka ndodhur kjo.

**Rreziku** Mbajtja e pozitës së Ambasadorit në mënyrë të pa autorizuar, mund të ndikoj që shteti të përfaqësohet nga personat zyrtar që nuk kanë vendime (dekrete) të vlefshme, dhe të paguhen pa ndonjë bazë të qartë ligjore.

**Rekomandimi C2** Ministri duhet t'i shqyrtoj rastet e tilla dhe të siguroj që personeli diplomatik, përfshirë edhe ambasadorët, posedojnë bazën e duhur ligjore për veprim në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi në misionet diplomatike, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) në vitin 2018 ishte 18,245,515€. Prej tyre ishin shpenzuar 17,020,117€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të qirasë për ndërtesa, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, furnizime për zyrë, shërbime për sigurime shëndetësore, shërbime komunale etj.

Për qëllime ekzaminimi, ne kemi përzgjedhur 100 mostra për testim substancial dhe pesë (5) për testim të pajtueshmërisë. Testime tona kanë rezultuar me gjetjet si më poshtë:

#### Rekomandimet

##### Çështja B3 - Vonesa në regjistrimin e shpenzimeve

**Gjetja** Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018<sup>3</sup>, i obligon MDK-të, që deri me datën 15 të muajit pasues, të dërgojnë raport të shpenzimeve në departamentin e financave në MPJ, për t'i regjistruar më tej shpenzimet në SIMFK.

Gjatë testimeve audituese, ne kemi vërejtur se në 29 raste kishte vonesa në regjistrimin e shpenzimeve. Vonesat ishin nga një (1) deri në tetë (8) muaj.

Disa nga shkaqet e kësaj gjendje kanë të bëjnë me vonesat në raportim nga MDK-të, nevoja për informata shtesë për arsyetim të shpenzimeve nga MDK-të, etj.

**Rreziku** Vonesat në regjistrimin e shpenzimeve ndikojnë që raportimet tremujore të jenë të pasakta, pasi ato nuk e tregojnë gjendjen e saktë të shpenzimeve të ndodhura. Kjo rrit rrezikun që shpenzimet e caktuara të mos përfshihen edhe në PFV.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike, përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informatat e sakta për të gjitha transaksionet financiare.

<sup>3</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e UA Nr. 03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në Misionet Diplomatike Konsullore të Republikës së Kosovës.

---

**Çështja A1 - Përfshirja e devijimit prej +/- 30% në kontratën me çmime të peshuara**

**Gjetja** Rregullorja dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, Neni 56.11 specifikon se në rastet kur Autoriteti Kontraktues (AK) nuk i din sasi të indikative tek "kontratat me çmime për njësi" duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull", në mënyrë që të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Ministria kishte nënshkruar dy kontrata me OE për nevoja të veta, të cilat kanë të bëjnë me: "Shërbime postare diplomatike" në vlerë 400,000€, dhe "Furnizimi me material shpenzues që është jashtë kontratës së Autoritetit Qendror të Prokurimit), në vlerë 124,500€. Përzgjedhja e ofertave fituese ishte bërë duke i peshuar çmimet në bazë të rëndësisë, mirëpo në kontratat e nënshkruara ishte cekur se devijimi i lejuar nga vlera indikative mund të jetë 30%. Kjo është në mospërputhje me rregullat e përcaktuara në rastet kur nuk dihen sasi të indikative të shërbimeve/artikujve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të ndryshimeve në stafin e departamentit të prokurimit, dhe nga mungesa e njohurive specifike nga stafi i ri, në lidhje me kërkesat e rregullore në këtë pikë.

**Rreziku** Përfshirja e devijimit +/-30%, kur kontrata është nënshkruar në bazë të vlerës së parashikuar, e jo në bazë të sasive indikative, paraqet rrezik për entitetin për hyrje në obligime të pa nevojshme, pasi që në këtë rast OE mund të kërkojë përmbushjen e kontratës në minimumin prej 70% të vlerës së saj të nënshkruar, pavarësisht se ministria mund të mos ketë nevojë për shërbimet apo blerjet e kontraktuara deri në atë masë.

**Rekomandimi A1** Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës të prokurimit i kuptojnë saktë kërkesat e legjislacionit në lidhje me prokurimin dhe kontratat, në mënyrë që kontratat të përpilohen në përputhje me rregulloret e aplikueshme, dhe të mos përfshihen elemente që në të ardhmen mund të shkaktojnë dëme financiare për Ministrinë.

**Çështja A2 - Tejkallim i afatit të paraparë për vlerësimin e ofertave**

**Gjetja** Sipas "Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik", përkatësisht neni 35 i këtij udhëzimi: Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 10 ditësh.



Ne kemi gjetur se te procesi i prokurimit për dosjen e tenderit “Sigurimi i automjeteve të MPJ-së”, kishte vonesa për përfundimin e vlerësimit, rreth 30 ditë (hapja e ofertave ishte bërë me 30.08.2018, dhe vlerësimi kishte përfunduar me datë 30.10.2018). Për këtë vonesë nuk ka pasur ndonjë arsye të veçantë.

Zyrtarët e MPJ nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë ndonjë arsye të qëndrueshme për ndodhjen e kësaj vonese, derisa ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit kishte filluar punën 12 ditë pas emërimit të anëtarëve, dhe kjo mund të kenë qenë një ndër arsyet e vonesave në vlerësim.

**Rreziku** Vonosat në përmbylljen e procesit të vlerësimit të ofertave, mund të ngrisin dyshime në transparencën e procesit, si dhe shkaktojnë vonesa në marrjen e shërbimeve.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet të siguroj se komisionet vlerësuese me përkrahjen e departamentit të prokurimit, i kryejnë vlerësimet e ofertave brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që shërbimet e kërkuara të merren në kohë, si dhe të sigurohet një proces sa më transparent.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 12,877€. Në vitin 2018 ky buxhet ishte shpenzuar në tërësi. Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me: subvencionimin e klubit të futbollit, përkrahje financiare për familjarët e nëpunësve të ndjerë të MPJ-së dhe subvencione për entitet jo publik.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 810,973€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 526,798€ apo 65%. Ato kanë të bëjnë me blerjen e veturave zyrtare, blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative etj.

---

## Rekomandimi

---

### Çështja A3 – Keqklasifikimi i shpenzimeve ekonomike

**Gjetja** Shpenzimet kapitale paraqesin pagesat për blerje të pasurisë të cilat kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe vlerë financiare më të madhe se 1,000€. Këto shpenzime kapitalizohen gjatë përdorimit në periudhat e ardhme.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se në pagesën Furnizim me Mobile për MPJ-në pagesa ishte bërë nga kategoria ekonomike Investime Kapitale, e në fakt këto shpenzime i takojnë kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime pasi që kanë vlerën më të vogël se 1,000€. Vlera totale e këtyre pagesave të bëra ishte 2,000€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të këtyre shpenzimeve.

**Rreziku** Pagesat e bëra nga kategoria e gabuar mund të rezultojnë me pasqyrim çorientues të shpenzimeve, duke nënvlerësuar një kategori dhe mbivlerësuar kategorinë tjetër të shpenzimeve, me ndikim përfundimtar edhe në prezantimin e pa saktë të PFV.

**Rekomandimi A3** Ministri, nepërmjet personave përgjegjës duhet të sigurojnë se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël, në mënyrë që edhe realizimi i shpenzimeve dhe raportimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe korrekt.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV-të e vitit 2018 ishin shpalosur 2,856,369€ pasuri kapitale (me vlerë mbi 1,000€) dhe 1,284,268€ pasuri jo-kapitale (me vlerë nën 1,000€). Pasuria nën 1,000€ regjistrohet në regjistra të brendshëm të ministrisë, pasi në sistemin e-pasuria nuk mund të evidentohen pasuritë e MDK-ve, si dhe për faktin se ky sistem nuk është tërësisht funksional. Ne kemi testuar blerjet e vitit, përfshirë investimet kapitale dhe blerjet e pajisjeve dhe mobilieve me vlerë nën 1,000€, sikur se edhe rregullsinë e regjistrave dhe inventarizimin e pasurisë. Testimet tona kanë vënë në pah çështjet në vijim:

## Çështja B4 – Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive

**Gjetja** Menaxhimi i pasurive qeveritare dhe regjistrave ndërlidhur me to duhet të bëhet në pajtim me Rregulloren 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore. Derisa për qëllime të brendshme ministria kishte nxjerrë udhëzimin administrativ 06/2012 Për Regjistrimin e Pasurisë në Misionet Diplommatike Konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të së cilës MDK-të obligohen që pasurinë e blerë ta raportojnë te zyrtari i pasurisë në MPJ në mënyrë që pasuritë të regjistrohen në regjistrat kontabël.

Shtatë MDK<sup>4</sup> nuk i kishin raportuar fare pasuritë nën 1,000€, për vitin 2018. Si rrjedhojë informatat e prezantuara rreth pasurive nën 1,000€, nuk prezantojnë gjendjen reale.

Nuk ka ndonjë arsytim se përse MDK nuk kanë raportuar, me përjashtim të Konsullatës në Shqipëri dhe Zyrës Ndërlidhëse në Greqi të cilat janë hapur në fund të vitit 2018 dhe kjo mund të ketë ndikuar në mosraportimin e pasurive.

**Rreziku** Dobësitë në menaxhim dhe raportim me theks të veçantë në MDK, shpalosin mungesën e kontrollit të plotë mbi pasuritë dhe pengojnë menaxhimin efektiv dhe rrisin rrezikun e humbjes apo tjetërsimit të pasurisë.

**Rekomandimi B4** Ministri, nëpërmjet personave përgjegjës, duhet të siguroj funksionimin e mekanizmave të kontrollit në fushën e menaxhimit të pasurive, në mënyrë që menaxhohen në pajtim me rregullat dhe regjistrat e pasurive të ofrojnë informatat e sakta dhe të plota për pasuritë në dispozicion.

### 3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Pasqyra e avanceve të hapura të prezantuara në PFV për vitin 2018 ishte 193,868€, dhe nuk janë dhënë sqarime shtesë në lidhje me to. Megjithatë në bazë të shënimeve të SIMFK-së, vlera e avanceve të hapura ishte 230,298€ në kodin ekonomik 71200. Ato kanë të bëjnë me avance për ambasadat, avance për udhëtime zyrtare, dhe shpenzime të pa mbyllura/arsyetuara që janë realizuar me kredit kartela.

<sup>4</sup> Ambasada në Hungari; Ambasada në Japoni; Ambasada në Shqipëri; Konsulata në Munih; Konsulata në Cyrih, Konsulata në Shqipëri dhe Zyra Ndërlidhëse në Greqi.

---

## Çështja A4 - Mangësi në menaxhimin e avanceve

**Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Shpenzimet e Udhëtimeve Zyrtare, shpenzimet e mjeteve të marrura avanc, duhet të arsyetohen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Rregulli i njëjtë vlen edhe për shpenzimet e realizuara përmes kredit kartelave.

Ne kemi vërejtur se Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2018 përmes kredit kartelave në vlerë 67,959€, nuk janë arsyetuar sipas kërkesave. Kjo e ka rritur vlerën e avanceve të pa arsyetuara në PFV. Përveç kësaj ne kemi identifikuar një rast ku avanci për udhëtim zyrtar në vlerë 6,000€, i tërhequr në fund të vitit 2017, nuk ishte arsyetuar fare. Ky avanc nuk ishte paraqitur në PFV 2018.

Pas pranimit të draftraportit të auditimit, janë mbyllur/arsyetuar shpenzimet me kredit kartela në vlerë 39,087€. Veç kësaj, 5,600€ tjera, në pamundësi të arsyetimit të shpenzimeve, janë kthyer para të gatshme nga shfrytëzuesi i kredit kartelës. Gjithashtu, edhe mjetet nga avanci i vitit 2017 prej 6,000€ janë kthyer, dhe të njëjtat janë në procedurë të regjistrimit në Thesar.

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos-mbyllja e avanseve, rritë rrezikun që paratë publike të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara dhe me rregullat e aplikueshme.

**Rekomandimi A4** Ministri duhet të siguroj se në të gjitha rastet kur zyrtarët nuk i kanë arsyetuar shpenzimet e udhëtimit në pajtim me rregullat, shumat e pa arsyetara t'u ndalen nga pagat. Kjo do të ndikoj në rritjen e përgjegjësisë së stafit në kryerjen e obligimeve ligjore për arsyetimin e shpenzimeve dhe mbylljen e avanseve, në pajtim me rregullat në fuqi.

## 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 18,309€. Krahasuar më vitin 2017 kemi një zvogëlim të konsiderueshëm të obligimeve. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e OB-ve po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkaptujve të mësipërm të raportit. Ne po ashtu kemi zhvilluar një vizitë audituese tre ditore në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Vjenë të Austrisë. Puna audituese e ndërmarrë gjatë këtyre tre ditëve nuk ka vënë në pah mangësi që vlen për tu theksuar në këtë raport. Disa çështje të vogla (në lidhje me trajtimin e pasurive, servisimin e automjeteve dhe afatet e prokurimit) janë ngritur dhe diskutuar me Ambasadorin dhe stafin e tij.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse MPJ ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Përkundër iniciativës për krijimin e grupit punues, MPJ ende nuk kishte arritur të hartoj një plan strategjik gjithëpërfshirës institucional që do të definonte objektivat kyçe dhe do të mundësonte monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të pritura. Në mungesë të dokumentit strategjik nuk ka arritur të vihet në funksion as një proces i mirëfilltë për menaxhimin e rreziqeve që ndërliiden me përmbushjen e objektivave strategjike. Kjo situatë ishte reflektuar në pyetësonin e vetëvlerësimit të dërguar në Ministrinë e Financave.

Në veçanti, MPJ ka probleme me trajtimin e avanseve. Gjendja e avanseve mbetet e paqartë. Avanset paraqiten si llogari të pambyllura nga viti nga vit, dhe përkundër rekomandimeve të vazhdueshme, gjendja nuk është përmirësuar.

Fushë që kërkon zhvillim të mëtejshëm mbetet përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe menaxhimi i buxhetit. Procesi i barazimeve financiare me MDK-të kërkon përmirësim, me qëllim që të sigurohen evidenca të sakta dhe të evitohen mangësitë aktuale.

#### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditorë. NjAB kishte planifikuar gjashtë auditime për vitin 2018, të cilat edhe i kishte përfunduar. Auditimet kanë mbuluar fusha, si: (a) procesi i rekrutimit dhe gradimit (për vitin 2017); (b) shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit (për vitin 2017 dhe janar-prill 2018); (c) investimet kapitale

dhe subvencionet; (d) auditimi i dy ambasadave dhe (e) auditimi i procedurave të prokurimit në MPJ.

Nga gjithsej 28 rekomandime të dhëna, 12 ishin zbatuar në tërësi, tetë (8) ishin në proces si dhe tetë (8) ishin të pa adresuara.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2018 ku ishin shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut**

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

MPJ ka vendosur një sistem relativisht funksional të kontrolleve të brendshme që përfshinë ndarjen dhe delegimin e përgjegjësive, raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ende nevojiten masa të shtuara dhe mekanizma të reja kontrolli në raport me adresimin e çështjeve të identifikuara që lidhen me Misionet Diplommatike Konsullore.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2017 për MPJ ka rezultuar me 16 rekomandime. MPJ kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për PFV-të e vitit 2018, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, gjashtë (6) janë në proces dhe katër (4) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë detale për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Në këtë kontekst duhet të ndërmerren masa konkrete për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paregjistruara që po përsëriten vit pas viti. Po ashtu, duhet të bëhet prezantimi i saktë i avanceve të paarsyetuara.	Avancet e paarsyetuar a janë prezantuar ndaras, ndërsa gjendja e shpenzimeve të paregjistruara është e njëjtë.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	PFV	Ministri duhet të sigurojë se bëhet prezantimi i saktë i grantëve të donatorëve, si dhe të sigurojë që raporti i pasurive jofinanciare të jetë konsistent me shpalosjet. Gjithashtu, Ministri duhet të sigurojë që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e identifikuar nga auditimi. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.	Grantet e donatorëve janë paraqitur saktë nëPFV derisa pasuritë kapitale nuk janë prezantuar në vlerën e saktë.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
3	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të ndërmerr një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të realizimit të buxhetit për investime kapitale dhe fushave tjera të shpenzimeve për vitin 2017 dhe më herët, dhe të përcaktoj alternativa praktike për përmirësimin e realizimit të tij.	Gjendja është e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
4	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës të bëjnë planifikimin/parashikimin e të hyrave	Planifikimi i të hyrave	Rekomandim pjesërisht i

		dhe të rris nivelin e përgjegjësisë nga shefat e misionëve diplomatike për të shmangur vonesat dhe të sigurojë që të gjitha të hyrat regjistrohen me kohë në SIMFK.	është bërë, mirëpo ka vonesa në regjistrim.	pazbatuar.
5	Menaxhimi i personelit	Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës i dosjeve të personelit, për të siguruar se ato mbahen dhe azhurnohen në pajtim me kërkesat ligjore.	Nuk kemi hasur në raste të tilla në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar.
6	Menaxhimi i personelit	Ministri duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.	Gjendja është e njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Mallra dhe shërbime	Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së duhet të sigurojnë që pagesa e qirasë të bëhet në përputhje me Udhëzimet në fuqi, në mënyrë që mos të ketë tejkalime të shpenzimeve të lejuara.	Edhe pse ka tejkalim të shpenzimeve, të gjitha janë sipas UA dhe me aprovim të ZKA-së.	Rekomandim i zbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informata të sakta për transaksionet financiare.	Gjendja e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
9	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës ti zbatojnë kërkesat e rregullave të aplikueshme, në aktivitetet e prokurimit, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.	Nuk është përsëritur e gjetura.	Rekomandim i zbatuar.
10	Subvencion e dhe transfere	Ministri duhet të sigurojë, që çdo përfitues i subvencioneve të raportoj për shpenzimet e bëra ashtu siç parashihet me Marrëveshjet e Bashkëpunimit, me qëllim që të sigurohet se mjetet po shpenzohen në përputhje me qëllimin e destinuar.	Nuk ka pasur subvencion e të natyrës së tillë.	Rekomandim i zbatuar.
11	Investime Kapitale	Ministri duhet të sigurojë zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi në proceset e prokurimit	Nuk ka pasur gjetje	Rekomandim i zbatuar.



		dhe respektimin e kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.	të natyrës së tillë.	
12	Pasuritë	Ministri nëpërmjet personave përgjegjës, duhet të sigurojë funksionimin e mekanizmave të kontrollit në fushën e menaxhimit të pasurive, për të siguruar se pasuritë menaxhohen në pajtim me rregullat dhe regjistrat e pasurive të përmbajnë informatat e sakta dhe të plota për pasuritë në dispozicion të ministrisë. Informatat e njëjta duhet të barten edhe në PFV, për të shmangur mundësinë e modifikimit të opinionit të auditimit apo theksimin e çështjes.	Është bërë regjistrimi i pasurive të cilat nuk kishin të përfshirë TVSH, ndërsa të tjerat e kanë gjendjen e njëjtë.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
13	Obligimet	Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve përgjatë procesit të pranimit dhe procedimit për pagesë të faturave, për të shmangur vonesat në kryerjen e obligimeve. Obligimet e mbetura në fundvit duhet të raportohen saktë në PFV, për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të shmangur modifikimin potencial të opinionit apo theksimin e çështjes në lidhje me PFV-të.	Obligimet janë paraqitur, por ende ka vonesa në pagesën e faturave	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
14	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, të monitorohet në vazhdimësi dhe për progresin e arritur të raportohet në baza tremujore nga stafi përgjegjës.	Një pjesë e rekomandimeve kishin mbetura pa u zbatuar.	Rekomandim i mbyllur pjesërisht izbatuar.
15	Raportimi menaxherial	Ministri duhet inicijë rishikimin e legjislacionit sekondar në lidhje me shërbimin e jashtëm në mënyrë që të qartësohet saktë procedura e përfundimit të mandatit të përfaqësuesve diplomatik, përfshirë periudhat kohore të nevojshme dhe çështjet relevante për tërheqjen/ri-sistemimin e stafit diplomatik. Në rastet kur paraqitet nevoja për zgjatjen e Mandatit të përfaqësuesve të caktuar diplomatik, kjo duhet të bëhet me vendim apo shkresë nga Ministri, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.	Ketë vit kishte vetëm një rast ku shefi i misionit ka vazhduar ta mbajë pozitën pa vendim.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

16	Raportimi menaxherial	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e procedurave formale për menaxhimin e rreziqeve, në pajtim me kërkesat e MFK-së. Regjistri i rreziqeve duhet të monitorohet dhe azhurnohet në baza të rregullta kohore.	Është përpiluar regjistri i rreziqeve.	Rekomandim i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet adekuate për t'i adresuar problemet lidhur me shpenzimet e paregjistruara që po përsëriten vit pas viti. Po ashtu, Ministri duhet të sigurojë që e gjithë pasuria e blerë të regjistrohet në regjistra, dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta në lidhje me pasuritë. Veç kësaj, Ministri duhet të sigurojë që për të gjitha shënimet e prezantuara në PFV, do të bëhen shpjegime sqaruese, në mënyrë që ato të jenë të jenë të kuptueshme për shfrytëzuesit e tyre. Avancet e pa arsyeuara duhet të prezantohen me vlera të sakta dhe të jepen shpjegimet e nevojshme për to.		
2	Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të ndërmarr një vlerësim sistematik të arsyeve për mos-realizimin e projekteve kapitale, dhe për nivelin e ulët të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori. Planifikimi i buxhetit duhet të harmonizohet me projektet e gatshme për realizim, dhe procedurat e prokurimit të inicohen me kohë dhe në pajtim me alokimet buxhetore.		
3	Të hyrat	Ministri duhet të rris nivelin e përgjegjësisë tek shefat e MDK-ve dhe stafi tjetër përgjegjës, për të siguruar raportime të rregullta dhe me kohë, në lidhje me të hyrat e realizuara, në mënyrë që ato të regjistrohen me kohë në SIMFK si dhe të raportohen saktë në raportet periodike dhe në PFV.		
4	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet t'i shqyrtoj rastet e tilla dhe të siguroj që personeli diplomatik, përfshirë edhe ambasadorët, posedojnë bazën e duhur ligjore për veprim në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë në misionet diplomatike, konform Ligjit për Shërbimin e Jashtëm.		
5	Mallrat dhe shërbimet si dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj zbatimin e plotë të dispozitave ligjore në lidhje me regjistrimin e shpenzimeve, për t'i eliminuar vonesat në regjistrimin e tyre nga zyrtarët kompetent. Raportimet periodike, përfshirë pasqyrat financiare, duhet të përmbajnë informatat e sakta për të gjitha transaksionet financiare.		
6	Mallrat dhe shërbimet si dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj që personat përgjegjës të prokurimit i kuptojnë saktë kërkesat e legjislacionit në lidhje me prokurimin dhe kontratat, në mënyrë që kontratat të përpilohen në përputhje me rregulloret e aplikueshme, dhe të mos përfshihen elemente që në të ardhmen mund të shkaktojnë dëme financiare për Ministrinë.		
7	Mallrat dhe shërbimet si dhe	Ministri duhet të siguroj se komisionet vlerësuese me përkrahjen e departamentit të prokurimit, i kryejnë vlerësimet e ofertave brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që shërbimet e kërkuara të merren në kohë, si		

	komunalitë	dhe të sigurohet një proces sa më transparent.
8	Investimet Kapitale	Ministri, nëpërmjet personave përgjegjës duhet të sigurojnë se me rastin e planifikimit të buxhetit, shpenzimet të planifikohen në kategorinë adekuate ekonomike sipas planit kontabël, në mënyrë që edhe realizimi i shpenzimeve dhe raportimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe korrekt.
9	Pasuritë Kapitale dhe jo kapitale	Ministri, nëpërmjet personave përgjegjës, duhet të siguroj funksionimin e mekanizmave të kontrollit në fushën e menaxhimit të pasurive, në mënyrë që menaxhohen në pajtim me rregullat dhe regjistrat e pasurive të ofrojnë informatat e sakta dhe të plota për pasuritë në dispozicion.
10	Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentë ve të saj	Ministri duhet të siguroj se në të gjitha rastet kur zyrtarët nuk i kanë arsyetuar shpenzimet e udhëtimit në pajtim me rregullat, shumat e pa arsyetara t'u ndalen nga pagat. Kjo do të ndikoj në rritjen e përgjegjësisë së stafit në kryerjen e obligimeve ligjore për arsyetimin e shpenzimeve dhe mbylljen e avanseve, në pajtim me rregullat në fuqi.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
MËTË PËRMBIJES DORËZUAR: DATE RECEIVED SUBMITTED:		24.06.2019	
Nivela Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shitë klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	1168	1



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government**Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs*

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raportit");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Fitim Sadiku.....  
Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme

Data: 24.qershor.2019, Prishtinë,